

Thirrja për Aplikim për Trajnimin: “Orientimi në karrierë”

Jemi të lumtur të njoftojmë hapjen e aplikimeve për trajnimin "Orientimi në karrierë".

Ky trajnim do të organizohet më 25 maj 2024 (e shtunë), si pjesë e nismave nga edicioni i parë Akademisë për Udhëheqësi në Komunitet (CLA), një program transformues mësimor 12-javor.

Ky trajnim intensiv është dizajnuar për t'i pajisur pjesëmarrësit me aftësi esenciale për një treg pune konkurrues, duke përfshirë komunikimin efektiv, ndërveprimin produktiv, përgatitjen e një CV profesionale me ndihmën e inteligjencës artificiale, si dhe strategjitë inovative të punësimit - të gjitha të fokusuara në një ditë të plotë angazhimi.

Për kë ofrohet ky trajnim?

A jeni nxënës/e i/e klasës 11/12 në një nga shkollat e mesme në Prishtinë?
Nëse përgjigja është PO, ky trajnim është për ty!

Çfarë ofron trajnimi ynë?

- **Trajnime nga ekspertët:** Sesione intensive njëditore me profesionistë të dalluar në fushën e zhvillimit profesional.
- **Sesione praktike:** Përvoja të thella që ju fuqizojnë të ndërtoni një bazë të fortë për karrierën tuaj në kohë rekord.

Sesionet e trajnimit përfshijnë:

- **Panel diskutimi:** Mundësitë e punësimit, lidhjet midis arsimit dhe punësimit dhe orientimit në karrierë.
- **Trajnime interaktive:** Krijimi i një CV efektive me ndihmën e ChatGPT.
- **Sesion:** Strategjitë dhe orientimi në karrierë.
- **Sesion:** Debati formal dhe aftësitë komunikuese.

Ky sesion njëditor përfaqëson një hap jetik drejt ndërtimit të një karriere të suksesshme dhe rritjes si lider/e në komunitetin tuaj. Mos humbisni këtë mundësi të artë për të zhvilluar aftësitë e buta që janë thelbësore për suksesin në mjedise profesionale dhe përtej.

Transporti dhe ushqimi janë të mbuluara nga organizatorët.

Afati i fundit për aplikim: 19 maj 2024 (e premte), në ora 23:59

Ky trajnim mbështetet nga Programi për Angazhim Qytetar, një iniciativë pesë vjeçare që zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me misionin e USAID në Kosovë.